

V E N D I M
Nr.403, datë 26.8.1999

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.214, DATË
28.4.1999 "PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE
NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, TË VLERAVE MESATARE TË TREGUT TË LIRË
TË BANESAVE DHE TË KOEFICIENTIT "K"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha" dhe në zbatim të pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.214, datë 28.4.1999 "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit "k", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.214, datë 28.4.1999 bëhen këto shtesa:

- Në tabelën "Të dhënat për tregun e lirë të apartamenteve, për vitin 1998" shtohet ky paragraf me këtë përmbajtje:

"Nr.	Rrethi	Mijë lekë/m2 sipërfaqe shfrytëzimi
1.	Saranda	24.16
2.	Tropoja	5.92
3.	Mirdita	13.43"

- Në tabelën "Vlerat e koeficientit "k", në mbështetje të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", shtohet ky paragraf me këtë përmbajtje:

"Nr.	Rrethi	Vlera e koeficientit "k"
1.	Saranda	0.87
2.	Tropoja	0.21
3.	Mirdita	0.48"

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko